REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq me 25.6.25

3201

PROJEKT- VENDIM – NR. 15

Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive Të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive Të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë në parim marrëveshjen e bashkëpunimit midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social Arsimit dhe Shëndetësisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 "Për vëtëqeverisjen Vendore" i ndryshuar .

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi . Pergj .Sektori i Arsimit dhe Shendetësisë	F.Mucollari		Dt 25.06.2025
Miratoi:Drejtoria e Shërbimit Social Arsimit dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 25.06.2025
Pranoi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit	A.Muka		Dt 25.06.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topciu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

3201 Maliq, më 25.06.2025

Relacion

Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive Të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive Të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq.

Objekti i marrvështjes

Objekti i kësaj shprehjeje interesi është bashkëpunimi ndërmjet **Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë** dhe **Bashkisë Maliq**. Në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive në përmbushje të detyrimit ligjor të hartimit të planeve lokale të shërbimit, shprehin interesin për të bashkëpunuar me qëllim hulumtimin dhe shpërndarjen e ekspertizës në fushën e arsimit parauuniversitar në nivelin vendor.ku bashkia shpreh angazhimin për t'u bashkuar në këtë iniciativë, duke bashkë-kontribuar me **30% të vlerës së këtij plani**.

Shërbimi i ekspertizës i ofruar nga Shoqata përfshin:

1. Analizë demografike dhe sociale e Bashkisë:

Ofrimi i një analize të detajuar të të dhënave demografike dhe sociale të Bashkisë, duke përfshirë informacion mbi popullsinë dhe strukturat sociale.

2. Përcaktimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe politikave:

Rishikimi dhe përcaktimi i kuadrit ligjor dhe politikave, bazë dhe referencë për t'u zbatuar në nivelin vendor në ofrimin e shërbimit të arsimit parauuniversitar dhe social nga bashkia.

3. Analizë të të dhënave dhe shërbimeve arsimore në nivelin parashkollor, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, si dhe shërbimit social:

Ofrimi i një analize të detajuar të të dhënave dhe shërbimeve arsimore dhe sociale, duke identifikuar sfidat dhe nevojat për përmirësim ose për arritjen e standardeve ligjore.

4. Zhvillimi i qëllimit të Planit të Arsimit Parauuniversitar, Barazisë Gjinore dhe Social për Bashki

Kontributi i Bashkisë

1. Sigurimi i të dhënave lokale:

Bashkia duhet të sigurojë të dhëna demografike dhe sociale të përditësuara, si dhe informacion për proceset dhe produktet e shërbimit që ofron Bashkia në fushën e arsimit parauniversitar dhe social. Këto të dhëna do të jenë të rëndësishme për analizat e mëtejshme.

2. Sigurimi i informacionit lidhur me institucionet arsimore dhe shërbimin social:

Bashkia do të ofrojë informacion lidhur me statusin dhe aspektet të detajuara.

3. Pjesëmarrja aktive në validimin e gjetjeve dhe nevojave për përmirësim:

Bashkia do të marrë pjesë aktive në validimin e gjetjeve dhe identifikimin e nevojave për përmirësim, përcaktimin e objektivave dhe masave strategjike, si dhe në identifikimin e aktiviteteve dhe projekteve që do të përfshihen në planet, duke i prioritarizuar ato.

4. Organizimin e konsultimeve dhe takimeve publike:

Bashkia do të luajë një rol kyç në organizimin dhe mbështetjen e konsultimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e aktorëve lokalë dhe transparencën në proces.

5. Buxheti dhe financimi:

Bashkia duhet të sigurojë informacionin e domosdoshëm për financimin e arsimit parauniversitar dhe shërbimit social në tre vitet e fundit, përfshirë të dhëna për kostot dhe projektet e realizuara. Gjithashtu, Bashkia do të kontribuojë në identifikimin e kostove dhe burimeve financiare të disponueshme për alokim, për planifikimin e masave strategjike dhe aktiviteteve të planit për një periudhë trevjeçare.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi . Pergj .Sektori i Arsimit dhe Shendetësisë	F.Mucollari		Dt 25.06.2025
Miratoi:Drejtoria e Shërbimit Social Arsimit dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 25.06.2025
Pranoi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit	A.Muka		Dt 25.06.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Toncia